



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Dep. DPK

Nr. Prot. _____
Br Prot. 03-02/1077/18
Prot No _____

Nr. Ifaq _____
Broj stranica 02
Na _____

Data _____
Datum 05-04-2018
Date _____



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.04.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2457/17, për zyrtarin e lartë znj.Luljeta Beqiri, Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokollit AKK-03-02-2454/17, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë znj.Luljeta Beqiri, Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”.

Nga procedura për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë znj.Luljeta Beqiri, figuron si person i autorizuar në biznesin privat me emër “Bentonit-G” SH.P.K, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.



Pas kësaj shkrese znj.Luljeta Beqiri, duke shfrytëzuar të drejtën për tu informuar lidhur me iniciimin e procedurës për të, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe ka shprehë interes për një takim me zyrtarët e AKK-së, për tu njoftuar për rastin që është duke u trajtuar.

Lidhur me këtë çështje është organizuar një takim me zyrtarin e lartë znj.Luljeta Beqiri, në këtë takim zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me rastin e iniciuar.

Znj.Luljeta Beqiri, në këtë takim është njoftuar me faktet e prezantuara nga zyrtarët e AKK-së dhe është pajtuar me gjendjen faktike, por është deklaruar se nuk ka qenë i informuar lidhur me obligimet që rrjedhin nga ligji PKI, por ka deklaruar se biznesi për të cilën behet fjalë nuk zhvillon veprimtari por ka mbet vetëm i regjistruar dhe figuron si person i autorizuar në këtë biznes, e në realitet nuk e ushtron këtë detyrë, por është zotuar se do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke hequr dorë nga funksioni si person i autorizuar i këtij biznesi, dhe me një herë pasi ti ndërmarr këto veprime do ta njoftoj Agjencinë duke sjell dëshmi.

Agjencia kundër Korrupsionit ka mbetur në kontaktë me zyrtaren dhe në ndërkohe nga ajo ka pranuar një deklaratë ku e njofton AKK-në, se i janë shfaqur disa probleme administrative duke pas parasysh se biznesi nuk ka licencë, mirë po është në procedurë për ti bër ndryshimet në biznese.

Duke parë se procedura për ndryshimet në biznes nga znj.Luljeta Beqiri po zvarriten AKK-ë i ka dërguar edhe shkresën e dytë paralajmëruese, ku i bën me dije se nëse nuk ndërmerren veprimet e parapara Agjencia kundër Korrupsionit do të veproj sipas ligjit në fuqi.

Pas këtyre procedurave dhe veprimeve të ndërmarra nga znj.Luljeta Beqiri, Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletin”, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë znj.Luljeta Beqiri, Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” ka ndërmarr veprimet e parapara, dhe dëshmohet se e njëjta nuk figuron me si person i autorizuar në biznesin privat me emër “Bentonit-G” SH.P.K.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga znj.Luljeta Beqiri, Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletin” duke bërë ndryshimet në biznes, dhe duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar në biznesin privat janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

